

Datë 13.11.2019

## **PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

**KOMUNA E PRISHTINËS**, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë dhe

OE-ik "NTP Ulpiana nga Prishtina, adresa –Matiqan pn. me numër të regjistrimit të biznesit dhe me numër fiskal 810498049 e përfaqësuar nga Shaban Buzoku –Drejtor ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike kornizë për punët e fasadimit dhe gëlqerosjes si në vijim:

"Kontrate kornize -LOT 1 Fasadimi dhe gëlqerosja ne shkolla dhe objekte tjera Komunale" me numër identifikues: 616-19-3413-5-1-1

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve te fasadimit dhe gëlqerosjes në vijim: "**Kontrate kornize -LOT 1 Fasadimi dhe gëlqerosja ne shkolla dhe objekte tjera Komunale**" me numër identifikues: 616-19-3413-5-1-1

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e puneve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit te kontratës dhe përfundon per 12 muaj .

### **Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 12 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë ne shkolla dhe objekte tjera komunale.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është [162.870,00 €] (nje qind e gjashtë dhjetë e dy mije e tetë qind e shtatë dhjetë euro e zero eurocent) . Devijimi i lejuar nga vlera totale indikativë dhe nga vlera per cdo pozicion është +/-[30 %].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe] në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
<b>Emri:</b>	Zekë Bardhaj	<b>Emri:</b>	NAIM PULIANA
<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	ING.
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	13.11.2019	<b>Data:</b>	13.11.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## **PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës ( apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitivave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie të kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e

përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk nje lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

### **Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

#### **Neni 5 Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### **Neni 6 Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

#### **Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

### **Obligimet e Kontraktuesit**

#### **Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsye të mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

## **Neni 9                      Personeli**

9.1 Kontraktuesi duhet të punësojë personel kyç dhe të përdorë pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

## **Neni 10                    Siguria e ekzekutimit**

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11                    Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12                    Programi**

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punëve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

### **Neni 13 Siguria në vend punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 14 Ndërhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

### **Neni 15 Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

### **Neni 16 Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

## **FILLIMI DHE VONESAT**

### **Neni 17 Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

### **Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do

të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### **Neni 19 Dëmet e likuiduara**

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të behen Kontraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:

*a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

## **Materialet dhe mjeshtëritë**

### **Neni 20 Regjistri i punës**

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishite, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasimore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishite dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

### **Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve**

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

### **Neni 22 Inspektimi dhe testimi**

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuase të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbyshjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

## **Neni 23      Paralajmërim i hershëm**

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

## **PAGESAT**

## **Neni 24      Parimet e përgjithshme të pagesave**

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-në për shkelje të tilla. AQPja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP

## **Neni 25      Paramasa dhe Paralogaria**

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

## **Neni 26      Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

## **Neni 27           Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

## **Neni 28           Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

## **Neni 29           Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

## **Neni 30           Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshhtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

(e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>shqipe</i>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>50 % e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muajsh</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15 dite pas nënshkrimit të kontratës.</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>12 muaj</i> .
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës me vendim nga ZKA
Pagesa		Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione për punët e kryera sipas raportit te menaxherit te kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare . Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve: 3 vite per secilin LLot
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	[a] Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.  Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# PERSHKRIM TEKNIKE

## Fasadimi dhe gelqerosja e shkollave dhe objekteve tjera komunale

-Kushte të përgjithshme:

-Përshkrimi i punëve. Ne perputhshmeri te plote me standartet EC dhe ISO.

-Paramasat dhe parallogaria eshte e dhene detalisht ne pershkrimin teknik, dhe I nenshtrohet pershkrimin teknik.

-Masat e sigurise: Duhet të jene në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shendetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyre duhet të bëhet rrethimi sa me i mire i punishtes dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preveniva) hapsinore në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes.

Punishtja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në toke. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikuqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin te instalimeve egzistuese te cilat ngelen ne sherbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

-Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakterisika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standartet EC dhe ISO.

**VERJEJTJE:** Te gjitha materialet e perdorura dhe te ekzekutuara duhet te deshmoen me ateste

### PUNIMET PËRGADITORE

-Çkyqja e përkohëshme e instalimeve eksistuese si dhe rikyqja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi I konzervimit te instalimeve egzistuese te cilat ngelen ne sherbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve

-Punimi I perkohshem I instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njesor- nga rrjeti, gjeneratori.

### PUNËT E DEMOLIMIT DHE PASTRIMIT

-Demolimi I mureve sipas pozicioneve të përcaktuara me projekt, pozicioni përshinë demolimin e murit, (nga betoni, blloku i argjiles, blloku i gazbetonit, knauf dhe tjera), instalimeve elektrike, ujësjellësit që gjenden në muri, ngarkimin si dhe transportin e mbeturinave ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres. Dimensionet e mureve mund te jene nga 5 deri 30 cm.

-Demolimi i radiatorëve trupave ngrohës me të gjithë pjesët mbajtëse dhe gypin furnizues. Kjo nenkupton largimin me kujdes te tyre, si dhe sanimin e demtimeve eventuale gjat demolimit, cilat do qofshin ato ( te gjitha keto duhet te kthehen ne gjendjen e meparshme).

### PUNIMET E MURATIMEVE

**Vërejtje:** Në çmim për muratim me blloka të argjillës duhet të parashihet edhe brezi shtangues 25x25 cm; 20x25 cm si dhe 12x25 cm (në varësi të trashësisë së murit I cili punohet me beton të armuar Klasa C25/30 dhe I armuar me armaturë 2Ø12 +2Ø12 dhe stafa Ø8/20 cm. Trau shtangues vendoset mbi nivelin e dyerve dhe dritareve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti.

-Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 25 cm.

-Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 20 cm.

-Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 10 cm.

-Furnizimi me material muratimi i mureve me pllaka gipsi me konstruksion metalik që ngjiten për murin ekzistues me një shtrese. Te perfshihet edhe fugimi I lidhjeve.

-Furnizimi me material muratimi i mureve me e pllaka gipsi me konstruksion metalik nga të dy anët me nga një pllakë, hapësira në mes të pllakave mund të shkoj deri 25 cm (pllaka gipsi rezistente ndaj lagështisë). Te perfshihet edhe fugimi I lidhjeve.

-Furnizimi me material dhe punimi i tavaneve me sistemin armstrong me konstruksion. Llojin dhe dizajnin e percakton organi mbikqyres.

-Furnizimi me material dhe punimi me kontakt beton para vendosjes së suvasë.

## PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES

Siperfaqja eshte e kalkuluar bruto perfshire shpaletat, kendoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit per fasade, kendoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nese jane me te medha se 2m<sup>2</sup> (vetem hapjet deri ne 2m<sup>2</sup> llogariten ne siperfaqe bruto). Ne kete pozicion perfshihen edhe te gjitha materialet dhe punet percjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteteve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti. Skelet duhet te jene ne lartesi deri 20 m'.

-Suvatimi i mureve te brendshme te objektit në minimum tri shtresave, me llaq-suva te parapergaditur I aplikueshem me makine sperkatese per llaq-suva.

-Suvatimi i tavanit te brendshme te objektit në minimum tri shtresave, me llaq-suva te parapergaditur i aplikueshem me makine sperkatese per llaq-suva.

-Perpunimi dhe gelqerosja e mureve me te gjitha pozicionet si ne vazhdim:

- 1.Gerryryja e mureve ne siperfaqet e demtuara
- 2.Sanimi I gerryrjeve me mase rrafshuese
- 3.Patinimi I mureve me glet mase
- 4.Ngjyrosja me baze ne dy shtresa
- 5.Ngjyrosja e mureve ne tri shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrylike, ekologjike.- Dedikuar për dekorimin e mureve të brendshme dhe të jashtme,- Lehtë I aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër,- I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë,- I përshtatshëm për nuancim,- Pa materie që avullohen

### Verejtje:

Te gjitha pozicionet perfshijne furnizimin, ekzekutimin, dhe mirembajtjen e hapsires gjate dhe pas kryerjes se punimeve.

-Perpunimi dhe gelqerosja e tavanaeve me te gjitha pozicionet si ne vazhdim:

- 1.Gerryryja e tavanit ne siperfaqet e demtuara
- 2.Sanimi I gerryrjeve me mase rrafshuese
- 3.Patinimi I tavanit me glet mase
- 4.Ngjyrosja me baze ne dy shtresa
- 5.Ngjyrosja e tavanit ne tri shtresa. Ngjyrë disperzive e kualitetit të lartë me bazë akrylike, ekologjike.- Dedikuar për dekorimin e hapsira të brendshme dhe të jashtme,- Lehtë I aplikueshëm, difuz në ujë dhe ajër,- I qëndrueshëm në fërkim dhe pastrim me leckë,- I përshtatshëm për nuancim,- Pa materie që avullohen

### Verejtje:

Te gjitha pozicionet perfshijne furnizimin, ekzekutimin, dhe mirembajtjen e hapsires gjate dhe pas kryerjes se punimeve.

-Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyrë yndyrore të klasit të parë sipas ISO Standardeve në lartësi te përcaktuar nga menaxheri prej dyshemesë, paraparakisht të bëhet lyerja me material bazë PVE.

-Ngjyrosja e mureve dhe tavanit me ngjyre speciale kunder mykut dhe lageshties, e dedikuar per perdorim te brendshem.

-Furnizimi dhe montimi I derrases perimetrike ne klasa te mesimit, e ngritur ne lartesi nga dyshemeja sipas udhezimeve te organit mbikqyres. Derrasa duhet te jete me dimensione (lartesi=20 cm, dhe trashesi=2.50 cm), e perpunuar ne siperfaqen e saj, e patinuar dhe e poliruar, gjithashtu duhet te jete e ngjyrosur me ngjyre baze per materiale te drurit, dhe ngjyre finale per mbrojten e drurit ne koloritin percaktuar nga ana e organit mbikqyres.

-Furnizimi me laser meter me gjatesi te matjes deri ne 100m', me nje devijim te saktesis jo me shume se ( $\pm 1.5$  mm). Paisja duhet te kete funksione te matjes se distances, llogaritje te siperfaqeve, llogaritje te velloimit, matje te kendit, lidhje me Bluetooth, si dhe memorie te brendshme. Paisja te jete sipas modelit (Bosch GLM 100 C) ose i ngjajshem, sipas specifikave te kerkuara. Paisja duhet te kete garancion se paku 3 vite nga dita e dorezimit te zyrtaret pergjegjes te Autoritetit Kontraktues.

-Furnizimi me kamer termale per nevoja te Autoritet Kontraktues, sipas pershkrimeve te kerkuara:

Specifikat minimale te paisjes duhet te jene:

- 1.Kamer infrared
  - 2.Rezolucioni, min (320 × 240 pixels)
  - 3.Pjeset tjera (Infrared kamera ,çante e fort per transport, Battery (brenda kameres) ,USB cable ,mbushesi sipas standardeve te EU.
  4. Komandat, (adaptimi I njesive matese (metric ose imperial), rregullimi I ores dhe dates, adaptimi I gjuhes)
  - 5.Forma e paisjes duhet te jete PISTOLE, me kamer para dhe ekran ne pjesen e pasme me LCD color
  - 6.Te kete lidhje me Wifi per transferimin e imazheve, te perkrahe punen ne PC dhe MAC.
- Paisja duhet te jete sipas modelit FLIR E8-XT ose e ngjajshme sipas specifikave te kerkuara. Paisja duhet te kete garancion se paku 3 vite nga dita e dorezimit te zyrtaret pergjegjes te Autoritetit Kontraktues.

# Fasadimi dhe gelqerosja e shkollave dhe objekteve tjera komunale

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

**Kushte të përgjithshme:**

**Përshkrimi i punëve. Në përputhshmeri të plote me standardet EC dhe ISO.**

**Paramasat dhe parallogaria është e dhënë detalisht në përshkrimin teknik, dhe i nënshtrohet përshkrimit teknik.**

**Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtës dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preveniva) hapsinore në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethosjes së punishtës. Punishtëja të rrethohet me tabela prej llamarinë dhe me konstruktion të përfunduar mirë në toke. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikujjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.**

**Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjashme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.**

**VERJEJTJE: Te gjitha materialet e perdorura dhe te ekzekutuara duhet te deshmohen me ateste**

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi (€)	Shuma (€)
<b>A</b>	<b>PUNIMET PËRGADITORE</b>				
1	Çkyqja e përkohëshme e instalimeve eksistuese si dhe rikycja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi i konzervimit të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve	komplet	10.00	5.00	50.00 €
2	Punimi i përkohshëm i instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njesor nga rreti, gjeneratori.	komplet	10.00	5.00	50.00 €
<b>Shuma A:</b>					<b>100.00 €</b>
<b>B</b>	<b>PUNËT E DEMOLIMIT DHE PASTRIMIT</b>				
5	Demolimi i mureve sipas pozicioneve të përcaktuara me projekt, pozicioni përshinë demolimin e murit, (nga betoni, blloku i argjilës, blloku i gazbetonit, knauf dhe tjera), instalimeve elektrike, ujësjellësit që gjenden në muri, ngarkimin si dhe transportin e mbeturinave në deponi të caktuar nga organi mbikëqyres. Dimensionet e mureve mund të jenë nga 5 deri 30 cm.	m <sup>2</sup>	1,000.00	0.30	300.00 €
6	Demolimi i radiatorëve trupave ngrohës me të gjithë pjesët mbajtëse dhe gypin furnizues. Kjo nenkupton largimin me kujdes të tyre, si dhe sanimin e demtimeve eventuale gjatë demolimit, cilat do qofshin ato ( të gjitha keto duhet të kthehen në gjendjen e meparshme).	copë	50.00	1.00	50.00 €
<b>Shuma B:</b>					<b>350.00 €</b>
<b>C</b>	<b>PUNIMET E MURATIMEVE</b>				
	<b>Vërejtje:</b> Në çmim për muratim me blloka të argjilës duhet të parashihet edhe brezi shtanguës 25x25 cm; 20x25 cm si dhe 12x25 cm (në varësi të trashësisë së murtit i cili punohet me beton të armuar Klasa C25/30 dhe i armuar me armaturë 2Ø12 +2Ø12 dhe stafa Ø8/20 cm. <b>Trau shtanguës vendoset mbi nivelin e dyerve dhe dritareve. Te gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtijë aktiviteti.</b>				
4	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 25 cm.	m <sup>2</sup>	490.00	3.00	1,470.00 €
5	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 20 cm.	m <sup>2</sup>	700.00	3.00	2,100.00 €
6	Furnizimi me material muratimi i mureve me blloqe të bardha (poroz beton i lehtë) me trashësi deri 10 cm.	m <sup>2</sup>	1,200.00	2.00	2,400.00 €
7	Furnizimi me material muratimi i mureve me pllaka gipsi me konstrukcion metalik që ngjiten për murin ekzistues me një shtresë. Te përfshihet edhe fugimi i lidhjeve.	m <sup>2</sup>	2,000.00	1.00	2,000.00 €
8	Furnizimi me material muratimi i mureve me e pllaka gipsi me konstrukcion metalik nga të dy anët me nga një pllakë, hapësira në mes të pllakave mund të shkoj deri 25 cm (pllaka gipsi rezistente ndaj lagështisë). Te përfshihet edhe fugimi i lidhjeve.	m <sup>2</sup>	2,000.00	2.00	4,000.00 €
9	Furnizimi me material dhe punimi i tavaneve me sistemin armstrong me konstrukcion. Llojin dhe dizajnin e percakton organi mbikqyres.	m <sup>2</sup>	1,500.00	8.00	12,000.00 €
10	Furnizimi me material dhe punimi me kontakt beton para vendosjes së suvasë.	m <sup>2</sup>	4,000.00	0.30	1,200.00 €

D	PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES				
	Siperfaqja eshte e kalkuluar bruto perfshire shpaletat, kendoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilatimit per fasade, kendoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nese jane me te medha se 2m <sup>2</sup> . (vetem hapjet deri ne 2m <sup>2</sup> llogariten ne siperfaqe bruto). Ne kete pozicion perfshihen edhe te gjitha materialet dhe punet percjellese te nevojshme per realizimin e aktiviteve. Te gjitha pozicionet perfshijne edhe materialin lidhes, skelet si dhe pastrimin e vendit pas realizimit te ketijë aktiviteti. Skelet duhet te jene ne lartesi deri 20 m.				
1	Suvatimi i mureve te brendshme te objektit ne minimum tri shtresave, me llaq-suva te parapergaditur i aplikueshem me makine sperkatese per llaq-suva.	m <sup>2</sup>	3,000.00	1.50	4,500.00 €
2	Suvatimi i tavanit te brendshme te objektit ne minimum tri shtresave, me llaq-suva te parapergaditur i aplikueshem me makine sperkatese per llaq-suva.	m <sup>2</sup>	3,000.00	1.50	4,500.00 €
3	-Perpunimi dhe gelqerosja e mureve me te gjitha pozicionet si ne vazhdim: 1.Gerryrja e mureve ne siperfaqet e demtuara 2.Sanimi i gerryrjeve me mase rrafshuese 3.Patinimi i mureve me glet mase 4.Ngjyrosja me baze ne dy shtresa 5.Ngjyrosja e mureve ne tri shtresa. Ngjyre disperzive e kualitetit te lartë me baze akrilike, ekologjike.- Dedikuar per dekorimin e mureve te brendshme dhe te jashtme.- Lehtë i aplikueshem, difuz ne ujë dhe ajër.- I qëndrueshem ne fërkim dhe pastrim me leckë.- I përshatshëm për nuancim.- Pa materie që avullohen Verejtje: Te gjitha pozicionet perfshijne furnizimin, ekzekutimin, dhe mirembajtjen e hapsires gjate dhe pas kryerjes se punimeve.	m <sup>2</sup>	40,000.00	1.00	40,000.00 €
4	-Perpunimi dhe gelqerosja e tavanaeve me te gjitha pozicionet si ne vazhdim: 1.Gerryrja e tavanit ne siperfaqet e demtuara 2.Sanimi i gerryrjeve me mase rrafshuese 3.Patinimi i tavanit me glet mase 4.Ngjyrosja me baze ne dy shtresa 5.Ngjyrosja e tavanit ne tri shtresa. Ngjyre disperzive e kualitetit te lartë me baze akrilike, ekologjike.- Dedikuar per dekorimin e hapsira te brendshme dhe te jashtme.- Lehtë i aplikueshem, difuz ne ujë dhe ajër.- I qëndrueshem ne fërkim dhe pastrim me leckë.- I përshatshëm për nuancim.- Pa materie që avullohen Verejtje: Te gjitha pozicionet perfshijne furnizimin, ekzekutimin, dhe mirembajtjen e hapsires gjate dhe pas kryerjes se punimeve.	m <sup>2</sup>	15,000.00	1.00	15,000.00 €
8	Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve me ngjyre yndyrore të klasit të parë sipas ISO Standardeve në lartësi të përcaktuar nga menaxheri prej dyshemesë, paraprakisht të bëhet ljerja me material bazë PVE.	m <sup>2</sup>	20,000.00	1.00	20,000.00 €
9	Ngjyrosja e mureve dhe tavanit me ngjyre speciale kunder mykut dhe lageshties, e dedikuar per perdorim te brendshem.	m <sup>2</sup>	1,500.00	1.50	2,250.00 €
10	Furnizimi dhe montimi i derrases perimetrike ne klasa te mesimit, e ngritur ne lartesi nga dyshemeja sipas udhezimeve te organit mbikqyres. Derrasa duhet te jete me dimensione (lartesi=20 cm; dhe trashesi=2.50 cm); e perpunuar ne siperfaqen e saj, e patinuar dhe e poliruar, gjithashtu duhet te jete e ngjyrosur me ngjyre baze per materiale te drurit, dhe ngjyre finale per mbrojtjen e drurit ne kolonitin percaktuar nga ana e organit mbikqyres.	m	1,500.00	1.00	1,500.00 €
	Furnizimi me laser meter me gjatesi te matjes deri ne 100m', me nje devijim te sakte si jo me shume se (±1.5 mm). Paisja duhet te kete funksione te matjes se distances, llogaritje te siperfaqeve, llogaritje te vellimit, matje te kendit; lidhje me Bluetooth, si dhe memorie te brendshme. Paisja te jete sipas modelit (Bosch GLM 100 C) ose i ngjajshem, sipas specifikave te kerkuara. Paisja duhet te kete garancion se paku 3 vite nga dita e dorezimit te zyrtaret pergjegjes te Autoritetit Kontraktues.	copë	5.00	200.00	1,000.00 €

<p>-Furnizimi me kamer termale per nevoja te Autoritet Kontraktues, sipas pershkrimeve te kerkuara:          Specifikat minimale te paisjes duhet te jene:          1. Kamer infrared          2. Rezolucioni, min (320 x 240 pixels)          3. Pjeset tjera (Infrared kamera ,çante e fort per transport, Battery (brenda kameres) , USB cable ,mbushesi sipas standardeve te EU.          4. Komandat, (adaptimi I njesive matese (metric ose imperial), rregulimi I ores dhe dates, adaptimi I gjuhes)          5. Forma e paisjes duhet te jete PISTOLE, me kamer para dhe ekran ne pjesen e pasme me LCD color          6. Te kete lidhje me Wifi per transferimin e imazheve, te perkrahe punen ne PC dhe MAC.          Paisja duhet te jete sipas modelit FLIR E8-XT ose e ngjajshme sipas specifikave te kerkuara. Paisja duhet te kete garancion se paku 3 vite nga dita e dorezimit te zyrtaret pergjegjes te Autoritetit Kontraktues.</p>	copë	1.00	1,000.00	1,000.00 €
<b>Shuma D:</b>				<b>89,750.00 €</b>

E	PUNET E FASADES				
	<p>Sipërfaqja është e kalkuluar bruto përfshirë shpaletat, këndoret e nevojshme nga prodhuesi, fugat e dilabimit për fasadë, këndoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nëse janë me të mëdha se 2m<sup>2</sup> (vetëm hapjet deri në 2m<sup>2</sup> llogariten në sipërfaqe bruto). Në këtë pozicion përfshihen edhe të gjitha materialet dhe punët përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteteve. Të gjitha pozicionet përfshijnë edhe materialin lidhës, skeletin si dhe pastrimin e vendit pas realizimit të këtyre aktivitetit. Skelet duhet të jete në lartësi deri 20 m.</p>				
1	<p>Punimi i fasadës termike me stiropor N3 me trashësi 10 cm, pozicioni përfshinë këto aktivitetet:            a) Montimi i stiroporit me ngjites; përforcimi me tiplla (5 copë/m<sup>2</sup>)            b) Mveshja e sipërfaqeve me ngjites në dy shtresa ku përfshihen edhe llajset në këndore si dhe rrjeta rabc            c) Ngjyrosja me material bazë (grunt)            d) Mveshja e sipërfaqeve me abrib 2.5mm ku lloji i ngjyrës caktohen nga investitori</p>	m <sup>2</sup>	4,500.00	10.00	45,000.00 €
3	<p>Furnizimi dhe motimi i solbankes nga graniti artificial me trashësi jo me të vogël se 8 mm, duke përfshirë ngjitesin dhe të gjitha aksesoret për perfundimin e pozicionit sipas funksionit të tij.</p>	m <sup>2</sup>	500.00	3.00	1,500.00 €
4	<p>Furnizimi dhe punimi, montimi i solbankës nga llamarinat zinkuar me trashësi t=0,7mm, e përpunuar me palim në këtë pozicion të përfshihen shtangimet e nevojshme.</p>	m <sup>2</sup>	500.00	2.00	1,000.00 €
<b>Shuma E:</b>					<b>47,500.00 €</b>

POS	REKAPITULIMI	SHUMA
A	PUNIMET PËRGADITORE	100.00 €
B	PUNËT E DEMOLIMIT DHE PASTRIMIT	350.00 €
C	PUNIMET E MURATIMEVE	25,170.00 €
D	PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES	89,750.00 €
E	PUNET E FASADËS	47,500.00 €
<b>TOTALI:</b>		<b>162,870.00 €</b>

